



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A

Tiranë, më 06.05.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Implementimi i sistemit të fiskalizimit në Eterna dhe Shërbimi i Fiskalizimit (4 vite)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Paketa software për sisteme financiare**

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,600,000 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH

Në Eur: 200.265,66 (dyqind mijë e dyqind gjashtëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë gjashtë) Euro pa tvsh me kursin e kembimit të datës 06.05.2025

I.ARGUMENTIMI I MOS NDARJES NË LOTE

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” datë 23.12.2020,i ndryshuar të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsyetimit të mëposhtem:

Objekti i prokurimit është konceptuar si një i tërë dhe për këtë arsye është e pamundur të ndahet në lote.

Përsa më lart ndarja në lote do ta ndërlikonte dhe vështirësonte procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte problematika për implementimin dhe shërbimin e fiskalizimit.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e

ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III. ARGUMENTIMI VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, **Autoriteti ynë kontraktor**, ka zbatuar parashikimet e Nenit 76 të VKM nr.285 pika 1 b duke marrë oferta nga operatorët ekonomik të fushës. Ofertat janë administruar në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit dhe janë pjesë e dosjes.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: Afati i ofrimit të shërbimit do të jetë 3 (tre) muaj Implementimi dhe 4 (katër) vite mirëmbajtje.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën 392,000 (treqind e nëntëdhjet e dy mijë) lekë
Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 39 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

OSE

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- c) Standardin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, Certifikatat iso të kërkuara do të përmbushen nga i gjithë bashkimi, ku secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardit ISO, në përputhje me natyrën e zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Argumentimi 2.3.2/a: Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur dhe të paraqesë në sistemin elektronik të prokurimit Standardin ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë, pasi ky standard garanton që operatori ka një sistem të strukturuar dhe të certifikuar për menaxhimin efektiv të proceseve dhe cilësisë së shërbimeve që ofron. Ky kriter është thelbësor për të siguruar që produktet dhe shërbimet që ofrohen janë në përputhje me kërkesat e prokurimit kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, një certifikim i tillë i lëshuar nga një organ i akredituar ofron garanci për cilësinë dhe besueshmërinë e operatorit, duke minimizuar rrezikun e dështimeve dhe sigurimin e një vazhdimësie të qëndrueshme në projekt. Standardi ISO 9001:2015 promovon përmirësim të vazhdueshëm dhe është i njohur ndërkombëtarisht, duke rritur transparencën dhe sigurinë për përputhshmërinë e ofrimit të shërbimeve me nevojat dhe pritshmëritë e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi 2.3.2/b: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalent, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, pasi ky standard ndërkombëtar garanton që operatorët ekonomikë kanë implementuar kontrolle të

sigurta dhe praktika të mira për menaxhimin e informacionit. ISO 27001:2022 siguron mbrojtjen e të dhënave sensitive, minimizon rreziqet e aksesit të paautorizuar, dhe garanton një qasje të strukturuar ndaj menaxhimit të sigurisë kibernetike. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin infrastrukturë kritike dhe të dhëna të ndjeshme, ky standard siguron që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin dhe kompetencat për të trajtuar sfidat e sigurisë. Përcaktimi i këtij kriteri nga Autoriteti Kontraktor është jetik për të siguruar integritetin dhe besueshmërinë e sistemeve të përfshira në prokurim, duke përmirësuar në këtë mënyrë sigurinë e përgjithshme të informacionit dhe shmangien e incidenteve kibernetike.

Argumentimi 2.3.2/c: AK ka kërkuar që Operatori Ekonomik të paraqesë certifikimin ISO 20000-1:2018 për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, pasi ky standard është një garanci e cilësisë së ofrimit të shërbimeve në fushën e IT-së. Ky certifikim vërteton se Operatori Ekonomik ka zbatuar praktikën më të mira në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve IT, përfshirë planifikimin, realizimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. Duke u bazuar në një standard ndërkombëtar të njohur, si ISO 20000-1:2018, Autoriteti Kontraktor sigurohet që shërbimet e teknologjisë së informacionit të ofruara nga O.E të jenë në përputhje me kërkesat e prokurimit, duke garantuar cilësi, efektivitet dhe përputhshmëri me standardet më të fundit të industrisë.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit dhe shërbimit objekt-kontrate, duhet të disponojë minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës, të diplomuar në një nga porfilet e IT, **ose ekuivalente**, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

- a) *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.*
- b) *Të paktën 1 (një) punonjës në rolin e drejtuesit teknik të projektit, të certifikuar nga prodhuesi si Solution Developer (ose ekuivalente) dhe Systems Engineer (ose ekuivalente)*
- c) *Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si zhvillues zgjidhjesh (Solution Developer nga Microsoft ose ekuivalente).*
- d) *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikaciones*
- e) *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në HTML, CSS, JavaScript ose ekuivalente.*
- f) *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si specialist për administrimin e bazës së të dhënave të certifikuar nga prodhuesi*
- g) *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).*
- h) *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në sisteme operimi OS (operating systems).*

- i) *Operatori ekonomik duhe të ketë të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në zhvillim ëeb Services.*
- j) *Operatori ekonomik duhe të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar, minimalisht nivel Ekspert ne Siguri Kibernetike*

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentet në origjinal ose kopje të noterizuara për punonjësit e mësipërm, dokumentacionin si me poshtë vijon:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplomë e arsimit të lartë, duke përfshirë të gjitha degët e informatikës, shkencave kompjuterike, teknologjisë së informacionit, **ose ekuivalente**.
- Çertifikatat/Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituara nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës, për secilin specialist të kualifikuar (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).
- Listepagesat e shoqerise per te pakten 3 (tre) muajt e fundit ne te cilat stafi i sipërpermendur duhet te figuroje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për instalimin, integrimin, konfigurimin dhe vendosjen në punë të sistemeve objekt-prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit është i nevojshëm për të provuar që është i diplomuar në një nga fushat e kërkuara dhe është në marrëdhënie pune pranë operatorit/ve ekonomikë ofertues. Këto janë dokumenta provuese që i shërbejnë Autoritetit Kontraktor që punonjësit e deklaruar nga operatori ekonomik disponojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e shërbimit.

Argumentimi 2.3.3/a): Për të menaxhuar një projekt me kompleksitet të lartë, që përfshin instalimin dhe konfigurimin e një infrastrukture teknologjike të avancuar, e cila përfshin pajisje si antenat LoRaWAN (gateway), sensorët inteligjentë, pajisjet për menaxhimin e energjisë dhe serverin e rrjetit, është thelbësore që projekti të drejtohet nga një profesionist me përvojë të avancuar në menaxhimin e projekteve teknologjike. Një menaxher projekti me certifikim në nivel profesional dëshmon aftësi të specializuara për të ndjekur një qasje metodike, e cila përfshin planifikimin e saktë të burimeve, menaxhimin e riskut, organizimin dhe koordinimin efektiv të ekipeve teknike, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të performancës së projektit. Këto aftësi sigurojnë që projektet komplekse të realizohen brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Kualifikimi profesional është gjithashtu një garanci për përdorimin e praktikave më të mira dhe aplikimin e metodologjive të menaxhimit të projekteve që mbështesin arritjen e qëllimeve strategjike dhe operacionale të projektit. Në një projekt të tillë kritik, ku siguria dhe përputhshmëria me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare janë thelbësore, një menaxher me përvojë do të garantojë implementimin e saktë të protokolleve të enkriptimit dhe të integritetit të teknologjive të reja. Ai do të

luajë një rol kyç në koordinimin e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik, duke parandaluar problemet potenciale dhe duke siguruar që projekti të realizohet me cilësi të lartë.

Argumentimi 2.3.3/b): Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar si Solution Developer dhe System Engineer për të siguruar drejtimin teknik dhe zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit.

Argumentimi 2.3.3/c): Referuar kërkesave, natyrës dhe objektit të kësaj kontrate, shërbimeve të kërkuara, detyrat specifike të ofruesit të shërbimit të ndarë në faza në përputhje me implementimin e projektit, shfaqet i nevojshëm zotërimi i stafit me kompetenca në zhvillimin e zgjidhjeve software.

Argumentimi 2.3.3/d): Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës, duhen kryer testime të specializuara sipas praktikave të njohura ndërkombëtarisht. Kjo mund të sigurohet nëpërmjet punonjësve të certifikuar si testues të kredituar programi.

Argumentimi 2.3.3/e): HTML, JavaScript dhe CSS janë komponentë të pandashëm të zhvillimit të aplikacioneve web për të implementuar komponentët sipas kërkesave të kontratës. Për krijimin e ndërfaqeve web interaktive janë të domosdoshme njohuritë e përmendura në këtë kriter.

Argumentimi 2.3.3/f): Kjo kontratë ka për detyrë të administrojë bazat e të dhënave (database) mbi të cilat funksionon sistemi ekzistues dhe të gjithë komponentët e tjerë objekt i kësaj kontrate. Për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave.

Argumentimi 2.3.3/g): Kërkesa për një punonjës të certifikuar për "ITIL" ose ekuivalente lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST. Një çertifikim ITIL ose ekuivalente është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për çertifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre.

Argumentimi 2.3.3/h): Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar në sisteme operimi për të përmbushur me profesionalizëm shërbimin e instalimit. Këto sisteme do të konfigurohen për të patur disponueshmeri të lartë.

Argumentimi 2.3.3/i): Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar në zhvillim Web Services, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore, duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit dhe nderveprimet me palet e treta të sistemit.

Argumentimi 2.3.3/j): Përfshirja e të paktën një punonjësi të certifikuar si Ekspert të Sigurisë Kibernetike në nivelin Ekspert është e domosdoshme për të siguruar një qasje efektive ndaj sigurisë së informacionit. Këta ekspertë kanë njohuri të thella në identifikimin e rreziqeve të sigurisë kibernetike, si dhe përdorimin e teknologjive për të parandaluar sulmet potenciale.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku konfirmon se do të kryejë konfigurimin, implementimin dhe vënien në funksion të sistemeve, si dhe të marrë përsipër trajnimin e punonjësve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Konfigurimi, implementimi dhe trajnimi është i rëndësishëm për vënien në punë dhe funksionalitetin e sistemeve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar për fiskalizim dhe certifikimi të jetë i publikuar te “lista-e-subjekteve-te-certifikuara” në: Faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë të jenë të certifikuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vertetuar se disponojnë autorizimet perkatese per furnizimin e licensave/suporteve specifike te garancise, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributoret perkates si dhe qe do vijoje per të zbatuar kushtet e garancisë.”.

2.3.6 Operatori ekonomik, me qëllim që të demostrojë aftësinë për të përmbushur kërkesat teknike të procedurës, duhet të realizojë me sukses disa detyra specifike që përfshijnë modifikime në sistemin ekzistues të Postës Shqiptare, kërkesat të cilat do ti vendosen në dispozicion gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor kërkon realizimin e pikës 2.3.6 për tu siguruar që operatori ekonomik ka kapacitet teknik për të realizuar kërkesat sipas specifikimeve teknike.

SHËNIM:Sistemin qëndror Eterna i Postës Shqiptare, është markë e rregjistruar, të drejtën e pronësisë intelektuale dhe kodin në burim të sistemit Eterna “Posta Shqiptare: sh.a., nuk e disponon.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.*”

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, Ofertuesi fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

NJËSIA E PROKURIMIT